



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 1936/2 Prot.

Koplik, me: 05.08.2024

V E N D I M

NR, 39 DATË 31 / 07 / 2024

“Për një saktësim në VKB-në nr.25 datë 30.04.2024 “Për krijimin e këshillit artistiko-kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe ne mbledhjen e datës 31.07.2024 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 shkronja “d” dhe neni 25. Si dhe në mbështetje të ligjit nr.44/2015 për “Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr.540 datë 21.12.1992 “Për krijimin e këshillave artistiko-kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre” të ndryshuar, udhëzimit nr.1 datë 24.05.2005 të Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko – kulturor”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 6 datë 18.01.2024 “Për buxhetin e vitit 2024” me numër regjistri 08220 për Kulturën dhe VKB-së nr.25 datë 30.04.2024 “Për krijimin e këshillit artistiko-kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”

VENDOSI :

1. Të miratojë saktësimin e gjeneraliteteve për dy anëtarët e Këshillit Artistiko-Kulturor konkretisht si më poshtë:
Gjokë Luli në Gjok Lakaj dhe Isuf Heba në Isuf Heba.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Sportit, Shëndetësisë, Turizmit dhe Rinisë dhe Drejtoria e Finances dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”,

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 31.07.2024

Vota Pro 15

Vota Kunder 7

Vota Abstenim 3

Zbardhur me datë 02.08.2024

